

Serbia

Serbia ka bërë pak progres të dukshëm në çështjet e të drejtave të njeriut në vitin 2011, edhe pse Parlamenti Europian ratifikoi në janar Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit (MSA) të Bashkimit Europian me Serbinë, dhe arrestimet e Ratko Mladic dhe Goran Hadzic, dy të arratisurit e mbetur që kërkoheshin nga Gjykata Nderkombetare Penale për ish – Jugosllavinë (ICTY). Situata e minoriteteve etnike mbetet shqetësuese, gazetarë të pavarur përballen me kërcënime dhe dhunë, ndërsa sistemi i azilit ka nevojë të reformohet. Tensionet në rritje me Kosovën kanë acaruar dialogun midis Serbisë dhe BE –së.

Nga fundi i korrikut, duke mos pasur sukses të shtërngojë kontrollin e dy pikave kufitare, qeveria e Kosovës dërgoi trupa të armatosura drejt kufirit të veriut të Kosovës, e populluar nga serbët e Kosovës. Serbët lokalë ndërtuan bllokada rrugore për ti ndaluar dhe të shtënat shpërthyen duke vrarë një polic kosovar. Nga fundi i gushtit Kancelarja Gjermane Angela Merkel vizitoi Beogradin dhe paralajmëroi autoritetet serbe që të normalizojnë marrëdhëniet me Kosovën në mënyrë që Serbia të afrohet më shumë me anëtarësimin në BE.

Përgjegjshmëria për krimet e luftës

Në maj dhe korrik, respektivisht dy të dyshuarit e mbetur të ICTY – t për krimet e luftës, Ratko Mladic, komandanti ushtarak boshnjako – serb në kohën e luftës dhe Goran Hadzic, udhëheqësi i forcave separatiste kroato – serbe në kohën e luftës, u arrestuan në tokën serbe, duke i dhënë fund kështu periudhës së gjatë të pandërshkueshmërisë për krimet e luftës të kryera në Bosnje Hercegovinë dhe Kroaci. Gjatë vizitës së tij në Serbi në muajin shtator, Kryeprokurori i ICTY – t Serge Brammertz lavdëroi qeverinë serbe për arrestimin e Mladic dhe Hadzic, por gjithashtu theksoi rëndësinë e bashkëpunimit teknik të Serbisë me gjykatën për sa i përket proceseve gjyqësore aktuale. Për më tepër ai nënvizoi gjithashtu rëndësinë e bashkëpunimit rajonal në ndjekjen penale të kriminelëve të luftës.

Ndjekjet penale për krimet e luftës në vend kanë vazhduar në mënyrë të qëndrueshme, edhe pse Dhoma serbe për Krimet e Luftës është përballur me kritika gjithmonë e në rritje për progresin e paktë në vend sa i përket procedurave gjyqësore penale që lidhen me

periudhën e luftës dhe padive ndaj personave në lidhje me krimet e luftës, të cilat eventualisht ishin rrëzuar për mungesë provash.

Në mars, Jovan Divjak, një general boshnjak i ushtrisë në kohën e luftës, u arrestua nga policia austriake pas një urdhër arresti serb në Austri nën akuzat se ai ka kryer krime lufte në vitin 1991 kundër trupave të Ushtrisë së Popullit Jugosllav (JNA) në rrugën Dobrovoljacka në Sarajevë. Shumë OJQ dhe zëdhënës të OJQ – ve, duke përfshirë këtu edhe presidentin e Komitetit të Helsinkit të Serbisë, e dënuan këtë padi si të turpshme dhe provokuese, veçanërisht sepse Divjak është një anëtar aktiv i komunitetit të OJQ – ve. Gjykata e Rrethit Korneuburg në Austri e refuzoi kërkesën e Serbisë për ekstradim dhe Divjak u lirua në muajin Korrik. Sa i përket krimeve të luftës kundër Ushtrisë së Popullit Jugosllav (JNA) ka pasur edhe disa padi si edhe arrestime të tjera të rëndësishme – përfshirë këtu edhe atë kundër Ejup Ganic, ish zëvendës - presidenti boshnjak de facto gjatë luftës, si edhe atë kundër Ilija Jurisic, ish zyrtar i lartë i Ministrisë së Brëndshme gjatë luftës – të gjitha të rrëzuara eventualisht për shkak të mungesës së provave dhe presionit nga ana e OJQ-ve dhe zyrtarëve të qeverisë.

Liria e Mediave

Akte dhune kundër mediave të pavarura dhe gazetarëve mbetën një problem serioz. Milan Savatovic u dënua në maj me 10 muaj arrest shtëpiak, 3 vjet pas sulmit brutal të vitit 2008 mbi Bosko Brankovic, një kameraman i shoqërisë mediatike B92, gjatë një proteste kundër arrestimit të Radovan Karadzic. Dy bashkëpunëtorëve të Savatovicit iu pezulluan dënimet. Organizatat e gazetarëve kritikuan dënimet e lehta duke argumentuar se ligji Serb nuk i mbron siç duhet gazetarët.

Në janar dhe shkurt program televiziv i quajtur Insider raportoi një seri të titulluar “Shkeljet Fiskale të Shekullit” mbi akuza për abuzime financiare në bacinin e minierave të Kolumbarës, afër qytetit Lazarevac. Në vijim të raportimit, dhe me një sjellje të qartë kërcënuese, kriminele të panjohur në Lazarevac vendosën postera duke “njoftuar” vdekjen e gazetarëve të Insider.

Danilo Zuza dhe Milos Mladenovi, të cilët besohet se janë të lidhur me grupe nacionaliste ekstremiste, u arrestuan për rrahjen e komentatorit politik Teofil Pancic në korrik të vitit 2010. Në shtator të vitit 2010 ata u dënuan me 3 muaj burg edhe pse ligjërisht për këtë lloj krimi parashikohet një denim nga 6 muaj deri në 5 vjet. Megjithatë për shkak se nuk ishin dënuar asnjëherë më parë dhe për shkak të moshës së tyre (të dy nga 20 vjec) ata u

dënuan nën minimumin e parashikuar sipas ligjit. Pancic apeloj dënimet e ulta. Në nëntor Gjykata e Apelit në Beograd dënoi Mladonevic – in dhe Zuza – in me 7 muaj më tepër.

Parashtruar nga Ministria e Kulturës, qeveria e Serbisë po ekzaminon aktualisht një draft ligj të shumëpritur mbi strategjinë e medias. OJQ dhe shoqata gazetarësh në Serbi kanë kritikuar draftin sepse lejon që mediat të jenë vazhdimisht nën pronësinë e shtetit dhe për atë që sipas tyre cilësohet si mbrojtje e papërshtatshme kundër ndërhyrjes së politikës nëpër çështjet e mediave.

Trajtimi i Minoriteteve

Romët vazhdojnë të vuajnë nga diskriminimet dhe sulmet. Në mars një djalë romë u poshtërua në mënyrë të vazhdueshme me fjalë dhe u rrah para shkollës së tij të mesme; të rinjtë përgjegjës u arrestuan por nuk janë akuzuar ende. Në një incident të ngjashëm në maj tre persona rrahën një shtetas rom në moshë të rritur në një autobus në Beograd. Ata u arrestuan por ende nuk janë akuzuar.

Familjet rome që jetojnë në vendbanime informale në Beograd përballen me dëbime të detyruara me mundësi të limituara për strehim alternativ. Dymbëdhjetë familje rome u dëbuan pa paralajmërim nga shtëpitë e tyre nën urën Pancevo në qershor. Policia i shoqëroi ata në rrethinat e Beogradit që të jetonin në konteinera metali pa shërbime sanitare apo energji elektrike. Pesë familje u dëbuan nga shtëpitë e tyre në rrugën Skadarska, në Beograd, dhe e kaluan natën që pasoi duke fjetur në parqet e qytetit, edhe pse 22 OJQ bënë koalicion duke u kërkuar autoriteteve ti gjenin një strehim alternative.

Mbrojtësit e të Drejtave të Njeriut

Një paradë për të drejtat e homoseksualëve e planifikuar për në datën 2 tetor u anulua nga frika për dhunë massive. Vlerësimet mbi sigurinë nga ana e policisë treguan se mund të kishte pasur protesta dhe përplasje midis grupeve ekstremiste të kahut të djathtë dhe marshuesve. Shumë OJQ lokale dhe ndërkombëtare akuzuan autoritetet se u përkulën nga kërcënimet dhe se nuk arritën të ndërhyjnë ashtu siç duhet kundër deklaratave të urrejtjes. Në deklaratën e saj, Anje Rothmund, shefja e Zyrës së Këshillit të Europës në Beograd, u shpreh se ishte shumë e shqetësuar për shkallën e urrejtjes dhe dhunës në shoqërinë serbe, gjë që çoi në anulimin e asaj parade.

Në prill të vitit 2011, një gjykatë serbe dënoi liderin e të djathtës ekstreme Mladen Obradovic me dy vjet burg për nxitje dhune gjatë marshimit të homoseksualëve në 2010 –

ën. Gjykata e Lartë e Beogradit gjykoi se Obradovic, lider i grupit ekstremist Honor, përdori dhunën për të shpërndarë grumbullimin dhe me qëllim që të nxiste urrejtjen dhe diskriminimin. Gjykata dënoi 13 të tjerë me burg në afatin nga 8 deri në 18 muaj. Aktivistët homoseksualë dhe liberalë thanë se dënimet ishin të rëndësishme si të parat në Serbi kundër diskriminimit ndaj homoseksualëve por u ankuan se ishin shumë të buta.

Kërkuesit e Azilit dhe Personat e Zhvendosur Brenda Vendit

Ligji i Serbisë për azilin hyri në fuqi në prill të vitit 2008, duke transferuar fuqitë në marrjen e vendimeve lidhur me azilin nga Zyra e Komisionerit të Lartë për Refugjatët të Kombeve të Bashkuara (UNHCR) tek zyra serbe për azil. Duke iu referuar të dhënave të Ministrisë së Brëndshme, 2.134 kërkues azili u regjistruan në Serbi nga fillimi i Janarit deri në fund të gushtit, një rritje marramëndëse nga 522 që ishin në 2010. Rritja duket se ndodhi për shkak të një fluksi emigrantësh përmes Greqisë, Turqisë dhe Maqedonisë. Në Serbi aktualisht ka dy qendra për kërkuesit e azilit në Banja Koviljaca dhe Bogovadja; ai në Bogovadja u hap në qershor dhe e ka arritur numrin e mundshëm të kapacitetit maksimal. Deri më tani nuk ka pasur denoncime për trajtime të këqija apo abuzime por UNHCR-ja raporton se ka shumë gjasa të kalohet kapaciteti maksimal.

Në mars Komisariati Serb për Refugjatët dhe Personat e Zhvendosur Brenda Vendit (PZHB), në bashkëpunim me UNHCR – në, publikoi një vlerësim mbi cënueshmërinë e PZHB – ve, në të cilin rezulton se në Serbi ka pasur 73.358 refugjatë, shumica prej tyre me origjinë kroate dhe 97.286 persona nga Kosova me nevoja që lidhen me zhvendosjen e tyre në Serbi.

Në mars UNHCR – ja raportoi se Serbia (përfshirë Kosovën) dërgoi 28.900 kërkues azili në Europë dhe Amerikën e Veriut në vitin 2010. Sipas UNHCR- së, grupi më i madh i kërkuesve të azilit në botë në 2010 -ën ishin nga Serbia (përfshirë Kosovën). Duke iu referuar ministrit të brendshëm të Serbisë, 95 përqind i aplikuesve serb për azil, në vendet e Europës Perëndimore i përkasin minoriteteve etnike, shumë prej tyre Romë me origjinë serbë dhe kosovare.

Aktorët Kryesorë Ndërkombëtarë

Ratifikimi nga ana e Parlamentit European i Marrëveshjes së Stabilizim – Asociimit të BE – së me Serbinë shënoi një hap kryesor drejt anëtarësimit të kësaj të fundit në Bashkimin European. Në veçanti kjo rezolutë nënvizoi rëndësinë e eliminimit të strukturave paralele në Kosovën e Veriut dhe nevojën për të përmirësuar trajtimin e minoriteteve.

Në tetor Komisioni European rekomandoi që Serbia të bëhet një kandidat për t'u bashkuar BE -së “në kuptimin që Serbia të riangazhohet në dialogun me Kosovën.” Raporti i progresit shoqërues lavdëroi përpjekjet e Serbisë për reformën juridike dhe kuadrin e përmirësuar ligjor dhe politik për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, por bëri thirrje për përpjekje më të mëdha për të ju kundërvënë kërcënimeve dhe dhunës kundër gazetarëve dhe mediave dhe për të përmirësuar statusin e romëve.

Pas përmbledhjes në mars, Komiteti i Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e Diskriminimit Racor i kërkoi autoriteteve serbe që të ndalojnë dëbimet e detyruara të Romëve dhe të përmirësojnë mundësitë e tyre për arsimim dhe regjistrim. Në një raport të shtatorit mbi Serbinë Thomas Hammerberg, komisioneri i Këshillit të Europës për të drejtat e njeriut, këmbënguli mbi nevojën për të ju kundërvënë deklaratave të urrejtjes nga ana e grupeve ekstremiste të djathta, për të garantuar mbrojtjen e gazetarëve dhe për të përmirësuar situatën e të drejtave të njeriut për romët.

Kosova

Situata e të drejtave të njeriut në Kosovë u përmirësua pak në vitin 2011, në mes të negociatave ngurruese me Serbinë dhe tensioneve midis serbëve dhe shqiptarëve në kufirin verior që ndonjëherë çoi drejt dhunës. Sistemi i drejtësisë mbeti i dobët pavarësisht përpjekjeve për të përndjekur personat për korrupsion dhe krime lufte. Romët, Ashkalinjtë dhe Egjiptianët (një grup qe flet shqip me origjinë të supozuar nga Egjipti), e Kosovës mbetën të marginalizuar dhe të cënuar nga diskriminimi. Zgjedhjet e përgjithshme në dhjetor të vitit 2010 u zhvilluan pa dhunë por u shoqëruan nga parregullsi që vëzhguesit ndërkombëtarë thanë se vunë në dyshim rezultatet.

Mbrojtja e minoriteteve

Romët, ashkalinjtë dhe egjiptianët vazhduan të përballen me diskriminim të vazhdueshëm – veçanërisht sa i përket strehimit dhe mundësisë për shërbime publike – si edhe papunësinë më të lartë, ndërprerje të shkollës, dhe përqindjen e vdekshmërisë në Kosovë.

Pas një zjarri aksidental në janar në apartamentet e strehimit të tyre social në Plementina, afërsisht 250 Romë, Ashkalinj dhe Egjiptianë u dëbuan me forcë në një kamp të përkohshëm në qytet pa energji elektrike dhe mundësi të qëndrueshme furnizimi me ujë të vazhdueshëm. Gjatë verës pati një ndërprerje të ujit në kamp. Në momentin e këtij shkrimi riparimet ende nuk janë bërë në apartamentet e tyre dhe atyre iu desh të qëndronin në kampin e tyre të përkohshëm.

Tensioned midis serbëve dhe shqiptarëve në Kosovën e veriut u intensifikuan në muajin gusht, pasi autoritetet kosovare zunë pikëkalimet e kufirit në kufirin serb. Serbët në Kosovën veriore ngritën bllokada dhe zhvilluan protesta që zgjatën deri në nëntor, me një ngjarje fatale, vrasjen e një oficeri të policisë kosovare nga ana e protestuesve serb në një përleshje në kufi nga fundi i korrikut. Në shtator 16 serb dhe 4 paqeruajtës i Forcave Kosovare të drejtuar nga NATO – ja (KFOR) u plagosën në një përballje tek bllokadat serbe afër pikave kufitare.

Sipas zyrës së prokurorisë në Kosovë, prokurorëve vendas iu erdhën raporte për 60 incidente ndër - etnike gjatë 9 muajve të parë të vitit 2011. Raportet nga misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë treguan se megjithëse shumica e tyre ishin incidente të nivelit të ulët, përfshirë këtu edhe vandalizmat në vendet fetare në janar dhe shkurt, ato përfshinë një numër sulmesh serioze dhe vrasjesh.

Në muajin tetor një burrë serb u qëllua për vdekje dhe djali i tij u plagos në një fshat të komunës Orahovac. Në këtë moment policia duhet të bëjë ende arrestimet. Në muajin nëntor një burrë serb u qëllua për vdekje dhe tre serb, përfshirë këtu edhe një oficer policie, u plagosën në një aksident në Mitrovicë. Policia është duke hetuar në këtë moment.

Në muajin tetor Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë (OSBE) i bëri thirrje autoriteteve kosovare të bëjnë më shumë për të mbrojtur të rikthyerit serbë në një fshat në komunën Ferizaj pas një sulmi me zjarrvënie në një varrezë ortodokse në tetor dhe një mori vjedhjesh dhe grabitjesh që nga muaji gusht.

Rikthimi i Refugjatëve dhe Personave të Zhvendosur Brenda Vëndit

Në mars Zyra e Komisionerit të Lartë për Refugjatët të Kombeve të Bashkuara (UNHCR) raportoi se në vitin 2010 Serbia dhe Kosova nxorrën numrin më të lartë të aplikuesve për azil në vendet “ e industrializuara”. Kjo rritje i atribuohet liberalizimit të vizave me Serbinë dhe problemeve ekonomike dhe diskriminimit me të cilat përballen minoritetet në Kosovë. Shumica e aplikimeve u bënë në Europë. Sipas UNHCR – së shumë aplikues ishin të origjinës rome, ashkalinjë dhe egjiptianë nga Kosova. Pothuajse të gjitha kërkesat u refuzuan.

UNHCR – ja në Kosovë regjistroi një total prej 695 minoritarë të rikthyer vullnetarisht në 7 muajt e parë të vitit, një ulje nga maja e vitit 2010: 237 serb, 76 romë, 187 ashkalinj, dhe

egjiptianë, 36 boshnjakë, 68 gorani, 12 shqiptarë (drejt zonave me shumicë serbe, kryesisht në Mitrovicë), dhe 7 malazez.

Dëbimet e kosovarëve nga Europa perëndimore vazhduan, të shoqëruara me ndihmë të pakët për të rikthyerit mbas mbërritjes në Kosovë. Sipas UNHCR –së 1.334 kosovarë u dëbuan nga Europa perëndimore gjatë shtatë muajve të parë të vitit 2011, përfshirë këtu edhe 336 persona në zonat ku ata ishin në minoritet: 168 romë, 76 ashkalinj, 5 egjiptianë, 22 boshnjakë, 8 gorani, 3 turq, 16 shqiptarë dhe 38 serbë.

Dëbimet vazhduan të kenë impakt disproporcional mbi komunitetet rome, ashkalinj dhe egjiptiane, ku shumica e të rikthyerve jetonin në strehime informale duke iu munguar gjërat më bazë si uji i vazhdueshëm dhe energjia elektrike. Fondi i Fëmijëve të Kombeve të Bashkuara raportoi në gusht se shumica e fëmijëve romë, ashkalinj dhe egjiptianë që u rikthyen në Kosovë janë tashmë në regjistrin kombëtar, duke iu dhënë atyre kështu të drejtën ligjore për arsimim dhe shërbime të tjera sociale. Tre e katërta e tyre ende nuk frekuentojnë shkollën si pasojë e varfërisë, të programeve të ndryshme mësimore dhe barrierave gjuhësore.

Bundeslandi verior i Gjermanisë, Nordrhein Westfalen, që strehon numrin më të madh të romëve të Kosovës, ashkalinjve dhe egjiptianëve në Gjermani, i pezulloi rikthimet forcërisht të romëve, ashkalinjve dhe egjiptianëve për muajt e dimrit të vitit 2010 dhe 2011, për shkak të shqetësimeve për sigurinë e tyre në Kosovë. Rikthime të forcuara nga Bundeslandi Nordrhein Westfalen vazhduan sërish në muajin prill të vitit 2011, megjithatë vlerësimet me nuanca të ndryshme që u bënë në shtator të viti 2010 nxorën në pah se ishte më pak e mundur që fëmijët në moshë shkollore të dëboheshin.

Në mars dhe prill të vitit 2011 aktivistë dhe drejtues të komunitetit rome shprehën shqetësime sa i përket mungesës së trajtimit për helmimet e shumicës së banorëve të mëparshëm të kampit të kontaminuar nga minerali i plumbit në Mitrovicë i vili u mbyll në muajin tetor të vitit 2010. Një kamp i ngjashëm i kontaminuar në Osterode mbeti i hapur sepse pothuaj 20 familje që vazhdonin të banonin atje ishin të frikësuar nga dhuna dhe diskriminimi në rast se ato do të riktheheshin në banesat e tyre të mëparshme në jug të Mitrovicës. Në muajin korrik të vitit 2011 autoritetet në veri të Mitrovicës arritën në një marrëveshje me Mercy Corps dhe me Komisionin European për të vënë një truall në dizpozicion për shtëpi për këto familje.

Pandëshkueshmëria, Përgjegjshmëria dhe e Drejta për Drejtësi

Rigjykimi i pjesshëm i Ramush Haradinaj në Gjykatën Ndërkombëtare Penale për ish – Jugosllavinë (ICTY), ish ministri i jashtëm kosovar dhe Idriz Balaj dhe Lahi Brahimaj, komandantë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), filloi në gusht mbi akuza lidhur me abuzimin me të burgosurit e kohës së luftës në një vend qëndrimi të UÇK – së. Një dëshmitar kryesor në hetimin e çështjes i cili nuk kishte pranuar të dëshmonte në seancën e parë, përsëri refuzoi të jepte prova duke thënë se ka frikë për sigurinë e tij, duke rizgjuar kështu shqetësimet për sigurinë e dëshmitarëve të cilat i kishte theksuar edhe Zyra e Apelit pranë ICTY –t kur vendosi për rigjykimin e çështjes.

Në janar Asambleja Parlamentare e Këshillit të Europës miratoi një raport nga parlamentari sviceran Dick Marty, duke aluduar se disa anëtarë të UÇK- së, përfshirë këtu edhe zyrtarë të lartë të qeverisë aktuale në Kosovë, kishin marrë pjesë në rrëmbime pas lufte, ndikuar në zhdukje dhe vrasje të serbëve, gjithashtu supozohet se janë marrë me trafik organesh dhe krimin e organizuar duke përfshirë armë dhe kontrabandë droge. Në maj BE -ja nëpërmjet Misionit Policor për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX) aprovoi një grup pune të veçantë për të hetuar mbi këto supozime. Në muajin gusht EULEX -i vendosi një prokuror amerikan me përvojë për të drejtuar hetimin.

Në tetor u hap në Prishtinë gjyqi i shtatë kosovarëve shqiptarë të akuzuar nga akuza të ndryshme për trafik organesh dhe qëniesh njerëzore, e njohur si çështja Medicus. Të pandehurit akuzohen se joshnin dhuruesit e organeve nga vendet e varfra që të vinin në Kosovë me premtime të rreme si pagesa të larta për veshkat e tyre.

Gjatë periudhës nga korriku 2010 deri në qershor 2011, EULEX -i përfundoi gjykimin e 5 çështjeve të luftës, 3 të tjera janë në gjykim e sipër dhe 67 janë në fazën e paragjyimit.

Ndjekja penale për krime lufte e Fatmir Limajt, deputet në Parlamentin të Kosovës në partinë në pozitë, u vonua nga marsi deri në shtator për shkak të konfuzionit nëse ai kishte imunitet parlamentar nga ndjekja penale. Në muajin shtator Gjykata Kushtetuese e Kosovës vendosi se ligjvënësit nuk kanë imunitet nga ndjekja penale dhe një gjykatë rajonale urdhëroi arrest shtëpie për të. Limaj akuzohet se ka torturuar dhe ka vrarë të burgosur serbë dhe shqiptarë në qytetin e Kleckës në vitin 1999.

Gjyqi i pashmangshëm u përball me një hap mbrapa nga fundi i shtatorit kur një dëshmitar kyç që ishte nën mbrojtjen e dëshmitarëve, Agim Zogaj, u gjet vdekur në një park në Gjermani. Ndërsa hetimet e policisë gjermane folën për vetëvrasje, familja Zogaj kritikoi

mbrojtjen që iu ofrua nga EULEX-i dhe thanë se Zogaj ka qënë nën presion të vazhdueshëm. Zyra e Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut të Kombeve të Bashkuara theksoi se ky rast nënvizoi sfidën e madhe të efikasitetit të programit të mbrojtjes së dëshmitarëve në Kosovë.

Liria e mediave

Në një letër të hapur në shkurt Christopher Dell, ambasadori i Shteteve të Bashkuara në Kosovë, akuzoi tre organizata mediatike - Koha Ditore, Koha Vision TV, dhe Express – për sjellje ilegale pasi ata siguruan dhe raportuan me mesazhe tekstuale dhe me një kasetë të regjistruar të bisedës mes Ambasadorit Dell dhe politikaneve kosovare gjatë zgjedhjeve presidenciale të atij muaji. Komisioni i Mediave të Pavarura në Kosovë çliroi këto tre publikime prej akuzave në të njëjtin muaj. Në muajin mars, Reporterët pa Kufij kritikuan ndërhyrjen e Dell si “ngacim të papranueshëm”.

Në muajin gusht EULEX-i lëshoi një padi kundër Rexhep Hotit dhe 4 personave të tjerë të personelit të Kosovo Infopress pas kërcënimeve të bëra në gazetë kundër një gazetareje premtuese Jeta Xharra në muajt maj dhe qershor të vitit 2009. Kërcënime erdhën pas raportit të Jeta Xharrës mbi kërcënimin e lirisë së mediave në Kosovë. Personat e paditur mund të kalojnë deri në 5 vjet në burg nëse dënohen.

Mbrojtësit e të Drejtave të Njeriut

Paneli i Rishikimit të të Drejtave të Njeriut të EULEX (HRRP), një trup këshillues që shqyrton ankimimet e sjella nga individë kundër EULEX-it, nxorri vendimin e tij të parë në prill (në një çështje punësimi) dhe një të dytë në qershor (mos zbatimi i një vendimi të gjykatës) duke thënë se EULEX theu të drejtën e pronës në të dyja rastet dhe të drejtën e barazisë së degjimit në rastin e dytë.

Aktorët Kryesorë Ndërkombëtarë

Në shkurt, në raportin e Këshillit të Europës, shefi i Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, Lamberto Zannier, nënvizoi para Këshillit të Sigurisë nevojën për një hetim të përsheptuar të akuzave për krime lufte dhe trafik organesh. Ai gjithashtu theksoi “parregullsi të mëdha dhe manipulime vote” gjatë zgjedhjeve të dhjetorit të vitit 2010. Parregullsitë e zgjedhjeve u kritikuan gjithashtu në janar edhe nga Ulrike Lunacek, raportuesja e Parlamentit Europian për Kosovën.

Komiteti për Parandalimin e Torturës, pjesë e Këshillit të Europës, nxorri një raport në tetor, pas një vizite në korrik ku u vu re keqtrajtim i vazhdueshëm në rastet e mbikqyrjes policore në Kosovë dhe mungesë e sigurisë ligjore për ata që janë çuar forcërisht në institucione psikiatrike.

Në muajin tetor progresi i raportit vjetor i Komisionit Europian theksoi “të meta serioze” në zgjedhjet e dhjetorit të 2010 -ës dhe nevojën për përpjekje më të mëdha për tu përballur me krimin e organizuar, duke cituar mbrojtjen e dëshmitarëve “të dobët” si një pengesë e veçantë. Raporti theksoi mungesën e progresit sa i përket refugjatëve dhe të rikthyerve PZHB, dhe kushte të vështira për personat e zhvendosur. Ai i bëri thirrje autoriteteve që të bëjnë më shumë për të menaxhuar të drejtën e “arsimit, shëndetësisë, strehimit dhe të mbrojtjes sociale” për romët, ashkalinjtë dhe egjiptianët.